



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 495/5 prot.

Tiranë, më 3.10.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Petrit Çano
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, neni 63, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 18.9.2019, është njoftuar vendimi nr. 183, datë 19.7.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Petrit Çano, prokuror/Drejtnes i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, me detyrë prokuror, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 1998 - 2000, ka ushtruar detyrën e prokurorit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën 2000 - 2008, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 2008 - 2015, prokuror dhe Drejtues i

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe nga viti 2015 e në vazhdim, prokuror/Drejtuës i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Petrit Çano ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezultoi se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Petrit Çano*”, në përfundim të veprimeve verifikuese, konstaton për subjektin se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin parashtrohet fakti se vlerësimi kryhet në mungesë të informacionit nga ana e SHISH-it<sup>1</sup>, i ka referuar Komisionit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

3.3 GPPP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku, Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo elemente që cenojnë etikën e subjektit të rivlerësimit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaramet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme për krijimin e tyre.* [...].

4.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, duke iu referuar raportit të lartpërmendur ka arritur në përfundimin se: [...] *nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar* [...], duke vlerësuar kështu se

<sup>1</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017 e DSIK-së (deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2018.

subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe është në kushtet e përshatshme për vazhdimin e detyrës<sup>2</sup>.

**4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

**5. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar së bashku kushtet për nivelin e besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, si dhe ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar, në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**7.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit (në vijim referuar si Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 – 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**10.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, dhe provave të administruara nga Komisioni, vlerëson se vendimi është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**11.** Nisur nga hetimi administrativ dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon vlerësimin të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara.

---

<sup>2</sup> F. 17 e vendimit.

12. Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk ka qenë i plotë, e për rrjedhojë përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr.183/2019, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm për kriterin e pasurisë, mjaftueshmërinë e deklarimit dhe shpjegimit bindshëm të burimit të ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, referuar përcaktimeve të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

13. Në këto kushte, në referencë edhe të faktit se raporti i DSIK-së është hartuar pa u administruar informacioni i SHISH-it, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

## II.A. Analiza e shkaqeve të ankimit

### II.A.1

14. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku, në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Në Deklaratën Vetting (në vijim referuar si D-Vett.), rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Çano, ka deklaruar: (i) në bashkëpronësi me bashkëshorten 1 (një) pasuri të paluajtshme të llojit apartament banimi; dhe (ii) në pronësi 100 % pjesë takuese të personit të lidhur me të, znj. \*\*\*. \*\*\*. (e bija), 1 (një) pasuri të paluajtshme të llojit apartament, si dhe (iii) likuiditete në formën e llogarive bankare dhe *cash*-it në banesë.

16. *Pasuria nr. \*\*\*, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me sipërfaqe 102.60 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*.\*\*\*”(ish-rruga “\*\*\* \*\*\*”), Tiranë (në vijim referuar si “Apartament banimi 102 m<sup>2</sup>”)*

16.1 *Në D-Vett.*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 102.6 m<sup>2</sup>, vlera 7.500.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: nuk përshkruhet.

16.2 *Në DV-2011*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 102.6 m<sup>2</sup>, vlera 7.500.000 lekë, 7.000.000 + 500.000 të dhëna në këtë vit dhe *burimi i krijimit*: me paratë e dhëna hua shtetasit \*\*\*.\*\*\*., të deklaruara më parë.

16.3 *Në DV-2006, DV-2007, DV-2008*, subjekti në rubrikën: “Të dhëna që nuk publikohen”, deklaron huat e dhëna shtetasit \*\*\*.\*\*\*., respektivisht: (i) 2.000.000 lekë në vitin 2006; (ii) 2.000.000 lekë në vitin 2007 dhe (iii) 3.000.000 lekë në vitin 2008.

16.4 *Në shpjegimet për Komisionin, të datës 29.10.2018*, subjekti deklaron se mospërmendja e burimit në D-Vett. është një pasaktësi e tij në plotësimin e formularit, pasi ka gjykuar se ishin të mjaftueshme të dhënat e deklaruara në DV-2011. Për burimin e të ardhurave, që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, subjekti deklaron: (i) shitjen e apartamentit të banimit në Fier; (ii) kursimet ndër vite dhe (iii) aktivitetin e bashkëshortes.

16.5 Referuar “Rezultateve të hetimit administrativ” dhe arsyetimit të vendimit, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar

subjektit të rivlerësimit barrën e provës në drejtim të aftësisë profesionale, një çështje etike, si dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për këtë të fundit, barra e provës i ka kaluar për sa vijon: (i) për të provuar pamjaftueshmërinë financiare për vitet 2006 dhe 2007, në shumën - 348.164 lekë; (ii) për të provuar shumat e deklaruara si fitim neto nga aktiviteti i bashkëshortes, si dhe (iii) në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga shitja e pasurive, në shumën 1.400.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur shpjegimet dhe dokumentacionin ku bazon pretendimet e tij.

16.6 Nga aktet në dosje që dëshmojnë rrethanat e krijimit dhe të burimit të të ardhurave të ligjshme për këtë pasuri, ndër të tjera rezultojnë:

- (i) Kontratë shitje e datës \*\*\*.12.2011, me nr. \*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., lidhur në Tiranë, noteri \*\*\*, \*\*\*. Palë shitëse z. \*\*\*, \*\*\*, palë blerëse z. Petrit Çano, me objekt: pasuri e paluajtshme me vendndodhje Tiranë, e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 102.6 m<sup>2</sup>, për çmimin 7.500.000 lekë, paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale.
- (ii) Shkresë me nr. \*\*\*prot., datë \*\*\*.10.2018, e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon në pronësi pasurinë me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, e llojit apartament me sipërfaqe 102.6 m<sup>2</sup>, shoqëruar me dokumentacion.
- (iii) Kontratë huaje pa interes, e datës \*\*\*.12.2006, me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., lidhur në Vlorë, notere \*\*\*, \*\*\*. Huadhënës z. P. Çano dhe huamarrës z. \*\*\*, \*\*\*, me objekt dhënien *cash* para noterës të shumës 2.000.000 lekë, për blerjen e një sendi të ardhshëm (apartament banimi) në truallin e palës huamarrëse, me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitjes së kësaj pasurie.
- (iv) Kontratë huaje pa interes, e datës \*\*\*.12.2007, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në Vlorë, notere \*\*\*, \*\*\*. Huadhënës z. P. Çano dhe huamarrës z. \*\*\*, \*\*\*, me objekt dhënien *cash* para noterës të shumës 2.000.000 lekë, për blerjen e një sendi të ardhshëm (apartament banimi) në truallin e palës huamarrëse, me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitjes së kësaj pasurie.
- (v) Kontratë huaje pa interes, e datës \*\*\*.12.2008, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në Vlorë, notere \*\*\*, \*\*\*. Huadhënës z. P. Çano dhe huamarrës z. \*\*\*, \*\*\*, me objekt dhënien *cash* para noterës të shumës 3.000.000 lekë, për blerjen e një sendi të ardhshëm (apartament banimi) në truallin e palës huamarrëse, me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitjes së kësaj pasurie.
- (vi) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\* .10.2018, e QKB-së, e cila konfirmon të dhënat mbi shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me administratore znj. \*\*\* \*\*.
- (vii) Shkresë nr. \*\*\* prot, datë \*\*\*.2.2019, dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, ku jepen të dhëna për detyrimet tatimore të subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k.
- (viii) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, ku jepen të dhëna për çregjistrimin e subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k..
- (ix) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2019, e Bashkisë Fier, ku jepen të dhëna për shlyerjen e detyrimeve tatimore të subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k.

16.7 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, pas analizës së bërë, ka konkluduar se: [...] nga vlerësimi në tërësi i pasurisë... vërehet se nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaramet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme për krijimin e tyre. [...] (f. 16 e vendimit, prg. i fundit).

16.8 Nga aktet në dosje konstatohet se për këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, z. Çano, lidhur me disa çështje, si: (i) diferencën në çmim midis çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes dhe çmimit të referencës; (ii) marrëdhënien e subjektit me shitësin \*\*\*, \*\*\* dhe (iii) nëse subjekti ka shqyrtuar çështje apo dhënë vendime, përfshirë dhe

ato të pushuara apo mosfilluara, ku shtetasi \*\*\*. \*\*\*. ose familjarë të tij kanë qenë palë, nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit nga institucioni përkatës në atë periudhë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vërtetim që është paraqitur prej subjektit.

**17. Komisioneri Publik** vlerëson se Komisioni nuk ka kryer një hetim administrativ të gjithanshëm e shteres, në tri drejtime kryesore: (i) konfliktit të interesit; (ii) veprimeve në dukje fiktive; (iii) burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara, të cilat i trajtojmë në vijim:

#### 17.1 *Konflikti i interesit*

Kontrata e shitblerjes e datës \*\*\*.12.2011, për pasurinë “apartament banimi 102 m<sup>2</sup>”, ka një çmim total prej 7.500.000 lekësh, ndërkohë çmimi i tregut të lirë, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008<sup>3</sup>, është në vlerën totale prej 17.955.000 lekësh. Komisioni, në vlerësimin e rrethanave që kanë çuar në këtë diferencë të konsiderueshme, rreth 60% më lirë, duhej të hetonte në drejtim të konfliktit të interesit, duke e shtrirë verifikimin në të gjithë periudhën e ushtrimit të funksionit nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe jo duke e kufizuar atë vetëm në periudhën kur ka ndodhur ngjarja (shitblerja). Sa më lart do të shërbente për të verifikuar në rast se rrethanat e mësipërme mund të përbëjnë favor, premtim apo trajtim preferencial për shkak të pozicionit të subjektit të rivlerësimit, përkundrejt pretendimeve të parashtruara nga subjekti se me z. \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*. e lidhte vetëm një miqësi e vjetër.

#### 17.2 *Veprimet në dukje fiktive*

Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme për “apartament banimi 102 m<sup>2</sup>”, më datë \*\*\*.7.2011, para lidhjes së kontratës së shitblerjes me subjektin e rivlerësimit më datë \*\*\*.12.2011, nga ana e shitësit \*\*\*. \*\*\*. \*\*, është kryer rivlerësimi i saj, paguar detyrimi përkatës për vlerën në shumën 17.955.000 lekë. Kjo diferencë e konsiderueshme rreth 60% më lirë, duhej të shërbente si indicie për Komisionin për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje, me qëllim për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj. Subjekti ka deklaruar<sup>4</sup> se dhe pagesa e rivlerësimit, në korrik 2011, është kryer po nga shitësi \*\*\*. \*\*\*. \*\*, çka ul akoma më shumë vlerën reale të përfituar nga ky i fundit (shitësi) për apartamentin e banimit 102 m<sup>2</sup>.

#### 17.3 *Burimi i ligjshëm i të ardhurave të deklaruara*

Në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruara, nga aktiviteti i personit të lidhur, znj. \*\*\*. \*\*\*. (bashkëshortja), ka rezultuar se D.R.T Fier, me shkresën e datës \*\*\*.2.2019, ashtu sikurse rezulton edhe në korrespondencën me ILDKPKI-në, ka konfirmuar se subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. ka detyrime të papaguara “tatim fitimi i thjeshtuar”, në shumën 110.000 lekë, për të cilën nuk konfirmohet se kujt viti i takon. Në këtë rast, identifikimi i vitit përkatës për të cilin janë shlyer detyrimet tatimore, ndikon në konsiderimin ose jo të së ardhurës së dekluar si e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

**18. Pasuria nr. \*\*\*, në pronësi të personit të lidhur znj.\*\*\* \*\*\*, (e bija e subjektit të rivlerësimit, pjesë e certifikatës familjare), me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament banimi 63 m<sup>2</sup>”)**

18.1 Në D-Vett., personi i lidhur deklaroi: apartament banimi me sip. 63 m<sup>2</sup>, vlera 53.000 euro (7.431.660 lekë) dhe burimi i krijimit: kursimet e prindërve.

18.2 Në DV-2014, personi i lidhur deklaroi: apartament banimi me sip. 63 m<sup>2</sup>, vlera 53.000 euro dhe burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet e prindërve, depozita Banka \*\*\*.

<sup>3</sup> Udhëzimi nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, i ndryshuar.

<sup>4</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetësorit të subjektit të rivlerësimit të datës \*\*\*.10.2018.

18.3 *Në DV-2014*, subjekti i rivlerësimit deklaron: likuiditete të pakësuara në vlerën 53.000 euro, për shkak të blerjes së apartamentit në emër të vajzës.

18.4 Nga aktet në dosje që dëshmojnë rrethanat e krijimit dhe burimit të të ardhurave të ligjshme për këtë pasuri, ndër të tjera rezultojnë:

- (i) Kontratë shitje e datës *\*\*\*.7.2014*, me nr. *\*\*\* rep.* dhe nr. *\*\*\* kol.*, lidhur në Tiranë, noteri *\*\*\*. \*\*\**. Palë shitëse znj. *\*\*\* \*\*\* (\*\*\*)*, znj. *\*\*\* \*\*\* (\*\*\*)*, znj. *\*\*\* \*\*\* (\*\*\*)* dhe znj. *\*\*\* \*\*\**, palë blerëse znj. *\*\*\* \*\*\**, me objekt: pasuri e paluajtshme me vendndodhje Tiranë, e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, për çmimin 53.000 euro, që do të kalojë nëpërmjet numrit të llogarisë bankare të noterit.
- (ii) Shkresë me nr. *\*\*\* prot.*, datë *\*\*\*.10.2018*, e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon në pronësi pasurinë me nr. *\*\*\**, zona kadastrale *\*\*\**, e llojit apartament me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, shoqëruar me dokumentacion dhe inventarin e brendshëm të dosjes.
- (iii) Shkresë me nr. *\*\*\* prot.*, datë *\*\*\*.6.2019* dhe nr. *\*\*\* prot.*, datë *\*\*\*.7.2019*, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me dispozitat e zbatueshme në shitjen e aseteve të një shoqërie tregtare (SHPK).
- (iv) Kontratë shitje e datës *\*\*\*.10.2010*, me nr. *\*\*\* rep.* dhe nr. *\*\*\* kol.*, lidhur në Vlorë, notere *\*\*\*. \*\*\**. Palë shitëse znj. *\*\*\* \*\*\**, në kushtet e mbylljes së aktivitetit të kopshtit “*\*\*\**” sh.p.k., palë blerëse z. *\*\*\* \*\*\**, me objekt mjete me natyrë, si: pajisje kuzhine, dollapë, tavolina, karrige, shtretër fjetje, mjete mësimore didaktike, për çmimin 1.400.000 lekë, të deklaruara të likuiduara.

18.5 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, pas analizës së bërë, ka konkluduar se: [...] *subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për të blerë apartamentin në vitin 2014. Nga verifikimi i likuiditeteve bankare provohet se shuma 53.000 euro është transferuar nëpërmjet llogarisë së noteres (f. 16 e vendimit).*

18.6 Nga aktet në dosje, megjithëse përpara një situatë të njëjtë (blerje me çmim më të ulët) me pasurinë e trajtuar më lart, nuk konstatohet që gjatë hetimit përkatës Komisioni të ketë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, z. Çano, për sa i përket vlerës së çmimit në kontratën e shitblerjes, nisur nga fakti se rezultojnë të jetë ndjeshëm më i ulët se çmimi i referencës.

**19. Komisioneri Publik** vlerëson se Komisioni nuk ka kryer një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, në këto drejtime kryesore: (i) konfliktit të interesit; (ii) pagesa në vlerën prej 1.023.335 lekë në aplikimin pranë ZVRPP-së Tiranë; (iii) veprimeve në dukje fiktive; (iv) burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga kontrata e shitjes në shumën 1.400.000 lekë, të cilat i trajtojmë në vijim.

#### 19.1 *Konflikti i interesit*

Kontrata e shitblerjes, e datës 11.7.2014, për pasurinë “apartament banimi 63 m<sup>2</sup>”, ka një çmim total prej 7.431.660 lekë<sup>5</sup>, ndërkohë *çmimi i tregut të lirë*, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008, është në vlerën totale prej 12.033.000 lekësh. Komisioni, në vlerësimin e rrethanave që kanë çuar në këtë diferencë të konsiderueshme, rreth 40% më lirë, duhej të hetonte në drejtim të konfliktit të interesit. Kjo diferencë e dukshme në çmim, duhej të trajtohej, sikurse pjesërisht është bërë për pasurinë “apartament banimi 102 m<sup>2</sup>”, në drejtim të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me palën shitëse, në këndvështrim të favoreve, premtimit apo trajtimit preferencial që do të kishte passjell çmimin e ulët.

#### 19.2 *Pagesa prej 1.023.335 lekë në aplikimin pranë ZVRPP-së Tiranë*

Nga dokumentet shoqëruese për pasurinë, dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, evidentohet edhe kërkesa e datës *\*\*\*.7.2014*, në të cilën pasqyrohet pagesa prej 1.023.355 lekësh, nga personi i

<sup>5</sup> Konvertuar çmimi në kontratë, që është 53.000 euro.

lidhur, znj. \*\*\* \*\*\*, ku përfshihet edhe tatimi mbi kalimin e pronësisë. Kjo vlerë ka efekt në analizën financiare për vitin 2014 (pasi rezulton se, duke e marrë në konsideratë dhe këtë shpenzim, deri në datën 16.7.2014, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë pagesat e kryera, përfshirë dhe shumën më sipër, ndaj duhej vlerësuar prej Komisionit). Sipas dispozitave nënligjore, që lidhen me pagesat e tatimit mbi kalimin e së drejtës së pronësisë, detyrimi për këtë pagesë qëndron te shitësi, ndërkohë që ky rregullim ligjor nuk ka kufizuar marrëveshje të palëve, ky detyrim është paguar edhe nga pala blerëse. Për më tepër, nëse pagesa në këtë rast do të ishte bërë nga pala shitëse, marrë në konsideratë dhe sa analizuar më sipër në pikën 20.1, do të duhej të shërbente si fakt hetimi për Komisionin, pasi vlera reale e shitjes (përfitimit monetar neto për shitësit) do të rezultonte akoma edhe më e ulët nga sa parashikohet në kontratën e shitblerjes.

### 19.3 Veprime në dukje fiktive

Sipas dokumenteve shoqëruese të shkresës së ZVRPP-së Tiranë, për pasurinë “apartament banimi 63 m<sup>2</sup>”, rezulton se vlera në shitje sipas udhëzimit nr. 9/2008 është 12.033.000 lekë, ndërkohë vlera e kontratës aktuale të shitjes është 7.431.660 lekë. Kjo diferencë e konsiderueshme rreth 40% më lirë, duhej të shërbente si indicie për Komisionin për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje, me qëllim për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj.

### 20.4. Ligjshmëria e burimit të të ardhurave të deklaruar prej 1.400.000 lekësh

20.4.1. Rezulton se Komisioni nuk ka hetuar në mënyrë ezauruese mbi burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës bankare prej 53.000 euro, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, që ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë “apartament banimi 63 m<sup>2</sup>”.

20.4.2. Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) likuiditete të shtuara nga të ardhurat nga puna publike dhe shitja e aktivitetit privat të bashkëshortes (nga 5.000.000 lekë të deklaruar vitin e kaluar në 50.000 euro), depozituar në bankën \*\*\*. Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaron dhe: (ii) të ardhura të përfituara nga shitja e asetëve (krevate, tavolina etj.), të aktivitetit të bashkëshortes, me kontratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2010, për shumën 1.400.000 lekë. Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit vetëm lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga shitja, e deklaruar nga subjekti edhe në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, ku rezulton se, në datë \*\*\*.5.2019, subjekti ka paguar shumën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga ky transaksion, në shumën 210.000 lekë.

20.4.3. Bazuar në dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe arsytimit të vendimit të Komisionit, rezulton se ky i fundit (Komisioni) nuk ka vlerësuar nëse të ardhurat në shumën 1.400.000 lekë, përfituar me anë të kontratës së shitjes të datës \*\*\*.10.2010, me nr. \*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., plotësojnë përcaktimet e parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme, **nga një burim i ligjshëm.**

20.4.4. Sikurse kemi mbajtur qëndrim edhe në ankime të tjera për raste të ngjashme, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në referim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, që një e ardhur të kualifikohet e ligjshme, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë për këto pasuri të deklaruar: (i) titullin juridik të krijimit të pasurisë, i cili duhet të jetë detyrimisht, në çdo rast, i ligjshëm (burimi), ashtu edhe (ii) pagesën e detyrimeve ligjore eventuale, që janë përmbushur (të ardhura të ligjshme). Duke u plotësuar kështu, në referencë të nenit D të aneksit të Kushtetutës, të dy kushtet në mënyrë kumulative, bazohet në një titull të ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji) dhe detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar me ligj. Pra, për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në



pronësi të një “pasurie të ligjshme”, duhet të përmbushen detyrimisht në mënyrë kumulative dy kushtet e parashtruara më lart.

- 20.4.5. Duke ju rikthyer rastit konkret, ndodhemi në kushtet kur Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurën prej 1.400.000 lekësh nga shitja e aseteve të shoqërisë së bashkëshortes, gjatë procesit të rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore për këtë të ardhur<sup>6</sup>, por Komisioni nuk ka vlerësuar nëse kontrata e shitjes e tetorit 2010, burimi që ka shërbyer për krijimin e këtyre të ardhurave, duhet të konsiderohet si një burim që rrjedh nga një titull/veprim juridik i ligjshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.
- 20.4.6. Nga hetimi administrativ i Komisionit, rezulton se ky i fundit, megjithëse evidenton faktin se shitja nuk është bërë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., por nga znj. \*\*\* \*\*\*, si individ, ka hetuar dhe vlerësuar vetëm nëse bashkëshortja e subjektit ka pasur detyrim të paguajë tatim për shumën e përfituar nga shitja e aseteve në vitin 2010, duke kërkuar dhe një interpretim ligjor nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019.
- 20.4.7. Nisur nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, kjo çështje ka gjetur trajtim në analizimin dhe vlerësimin e pasurisë “apartment banimi 102 m<sup>2</sup>”, ku subjektit të rivlerësimit i është kaluar barrë prove, ndër të tjera, edhe për të ardhurat e deklaruara nga shitja e aseteve në shumën 1.400.000 lekë (f. 11-13 e vendimit). Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 14.7.2019, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *Mobilim/pajisjet e blera në 2004-2005, në emër të individit \*\*\* \*\*\*, dhe për vitet 2006-2010, në emër të subjektit “\*\*\*\*”, siç ju kemi vënë në dijeni, janë shitur sipas kontratës... nga individi \*\*\* \*\*\*. Në këtë periudhë, subjekti tatimpagues kishte mbyllur aktivitetin dhe, për rrjedhojë, nuk mund të kryhej shitja në emër të subjektit... Për këto të ardhura të bashkëshortes time (në rolin e individit të deklaruara edhe në ILDKPKI, për vitin 2010) siç ju kemi informuar, është paguar tatimi në burim sipas legjislacionit tatimor...[...].*
- 20.4.8. Për sa më sipër, Komisioni konstatohet se konkludon se subjekti nuk ka pasur detyrim për të paguar tatimin në burim (f. 13 e vendimit).
- 20.4.9. Referuar provave të administruara, me qëllim vlerësimin nëse kjo e ardhur do të konsiderohet si e ardhur e ligjshme nga një burim/veprim ligjor i ligjshëm, kemi marrë në analizë rrethanat dhe aktet që kanë shërbyer në krijimin dhe burimin e këtyre të ardhurave, në raport me ligjin e zbatueshëm, e që në rastin konkret i referohemi ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe dy përgjigjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtuar Komisionit lidhur me këtë çështje.
- 20.4.10. Rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë ortakë dhe administratore e vetme e një aktiviteti privat, regjistruar si person juridik “\*\*\* ” sh.p.k., me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me seli dhe veprimtari në Fier.
- 20.4.11. Sipas përmbajtjes së kontratës së shitjes, e tetorit 2010, bashkëshortja e subjektit, znj. \*\*\* \*\*\*, në cilësinë e shitëses, dhe shtetasi \*\*\*. \*\*\*, në cilësinë e blerësit, kanë përcaktuar se: “*në marrëveshje mes tyre, pala shitëse i shet palës blerëse, në kushtet që ka mbyllur aktivitetin e saj si administratore e kopshtit..., i shet palës blerëse mjete me natyrë si vijon... ”.*
- 20.4.12. Rezulton se, para nënshkrimit të kësaj kontrate, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.2.2010, të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, është vendosur mbyllja e shoqërisë dhe caktimi i

<sup>6</sup> Subjekti ka depozituar urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.2019, me anë të së cilës provon pagimin e detyrimit tatimor.

likuidatorit, znj. \*\*\*. \*\*\*<sup>7</sup>, duke kaluar me status “Shoqëri në likuidim e sipër”, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (referuar si QKB), prej datës \*\*\*.2.2010<sup>8</sup>.

20.4.13. Në analizë të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjshmëria dhe efektet juridike që kanë rrjedhur nga veprimi juridik, kontrata e shitjes së aseteve të shoqërisë, e tetorit 2010, vihen në diskutim, duke ndikuar kështu dhe në vlerësimin mbi ligjshmërinë e të ardhurave që ka sjellë kjo kontratë. Sipas neneve 196/1 dhe 197/1, të ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se; “*Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij*” dhe se “*Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve...*”.

20.4.14. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në dy shkresat e drejtuara Komisionit<sup>9</sup>, ndër të tjera, pasi referon ligjin nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, parashtron se: “ [...]. *Individit, ortaku i shoqërisë nuk mund të shesë në emër të tij asetet, të cilat janë pronë e shoqërisë [...]*”.

20.4.15. Në vështrim të sa më sipër, në kushtet kur Komisioni nuk rezulton të ketë hetuar në këtë drejtim edhe pas marrjes së përgjigjes së mësipërme nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duket se kontrata e shitjes së aseteve të kopshtit, nga ana e bashkëshortes së subjektit është bërë në kapërcim të ligjit, pasi prej datës \*\*\*.2.2010, në cilësinë e administratorës, ortakes së vetme, e aq më pak në cilësinë e individit, personi i lidhur, znj. \*\*\*, nuk ka pasur të drejtë të disponojë dhe të shesë asetet e personit juridik, për më tepër asetet e një shoqërie në likuidim e sipër.

## **21. Pamjaftueshmëria financiare e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara**

21.1. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003-2016, ka rezultuar se, përveç sa më sipër trajtuar, për vitet 2005 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e kryera dhe kursimet respektivisht në vlerat negative 214.246 lekë, në vitin 2005, dhe vlerën negative 447.060 lekë, në vitin 2011.

21.2. Nga aktet e administruara në dosje, nuk rezulton që Komisioni, gjatë hetimit të kryer, t'i ketë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit apo kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën.

21.3. Metodologjia mbi bazë të së cilës është kryer analiza financiare, është si më poshtë:

### **a. Të ardhurat**

- Të ardhura nga pagat janë konsideruar të ardhurat sipas vërtetimeve respektive nga prokuroritë e rretheve, nga Drejtoria Rajonale Arsimore Fier dhe nga Bashkia Lushnjë për bashkëshorten, znj. \*\*\*. \*\*\*, si dhe nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për vajzën, znj. \*\*\*. \*\*\*.

- Të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes janë llogaritur bazuar në qarkullimin e deklaruar sipas konfirmimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Fier, zbritur shpenzimet të cilat evidentohen nga dokumentacioni, si shpenzimet e qirasë,

<sup>7</sup> Vendimmarrje në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit për shoqëritë tregtare dhe nenet 17 e në vijim të Statutit të kësaj shoqërie.

<sup>8</sup> Raporti i likuidimit të shoqërisë, i përgatitur nga likuidatori i caktuar, pasi ka nxjerrë si pasive të shoqërisë vetëm kapitalin themeltar të krijimit prej 100.000 lekë, rezulton të jetë miratuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve (të vetëm), më datë \*\*\*.2.2019, duke shfuqizuar edhe mandatin e likuidatorit. Ky fakt është reflektuar edhe pranë QKB-së, ku nga status “Shoqëri në likuidim e sipër”, ka kaluar me status: shoqëri e “çregjistruar”, me datë efektive: \*\*\*.4.2019.

<sup>9</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2019.

shpenzimet për paga, shpenzimet për sigurime shoqërore, shpenzimet për tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Në mungesë të hetimit, sikundër sqaruar më sipër në pasurinë: “Apartament banimi 102 m<sup>2</sup>”<sup>10</sup>, të ardhurat e deklaruara mbi qarkullimin e aktivitetit janë konsideruar të ardhura të ligjshme të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Në të ardhurat e bashkëshortes, nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat në formën e pagës, në rolin e administratores së shoqërisë, pasi në kushtet që nuk janë paraqitur listëpagesat e shoqërisë, nuk mund të identifikohet nëse shpenzimi i pagës së deklaruar i takon pagës së administratores apo të punësuarve të tjerë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale për pagën e pretenduar apo ndonjë dokument të kalimit të pagës në bankë (verifikuar kjo edhe nga lëvizjet e llogarive bankare), për të vërtetuar pagën e pretenduar të përfituar.

- Të ardhurat nga bonusi i karburantit nuk janë marrë në konsideratë, pasi nën orientimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vendimi (JR) nr. 7/2019, kemi vlerësuar, sikurse mbi trajtimin e dietave, edhe bonusi i karburantit të konsiderohet se ka shkuar për shpenzim, duke qenë se subjekti ka punuar dhe jetuar jashtë qytetit të banimit.

- Të ardhurat nga interesat janë marrë bazuar në lëvizjet e llogarive bankare.

- Të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë së vajzës së subjektit janë marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme, edhe pse tatimi rezulton i paguar gjatë procesit të rivlerësimit.

### **b. Shpenzimet**

- Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas praktikës së ndjekur në raste të ngjashme, referuar vendimeve përkatëse të institucioneve të rivlerësimit.

- Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur bazuar në të dhënat e sistemit TIMS për subjektin dhe personat e lidhur me të, sipas metodologjisë orientuese të Kolegjit.

- Shpenzimet e shkollimit të së bijës janë llogaritur bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe duke u verifikuar me pagesat e kryera për kurset e shkollimit, sipas lëvizjeve të llogarive bankare. Në mungesë të deklaratimit nga ana e subjektit, nuk janë llogaritur shpenzime qiraje për vitin 2014 e në vijim, vit në të cilin konstatohet se e bija ka punuar me kohë të plotë pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, fakt ky i pahetuar nga Komisioni.

- Shpenzimet e mobilimit janë llogaritur sipas deklaratimeve të subjektit në pyetësorët gjatë hetimit administrativ, llogaritur të gjitha në vitin e blerjes së apartamentit, duke konsideruar faktin që janë deklaruar në shuma minimale (6.000 euro për pasurinë “apartament banimi 102 m<sup>2</sup> dhe 250.000 lekë për pasurinë “apartament banimi 63 m<sup>2</sup>”).

- Shpenzimet e qirasë së apartamentit në Vlorë për periudhën kur ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, janë llogaritur bazuar në kontratën e qirasë (e nënshkruar për një periudhë 5-vjeçare) dhe deklaratimet e subjektit në pyetësor (se apartamenti është përdorur për të gjithë periudhën sipas kontratës).

### **c. Kursimet**

- Kursimet në *cash* janë llogaritur bazuar në deklaratimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka deklaruar kursime në *cash* vetëm në DV – 2009; DV – 2011; DV – 2015. Komisioni ka pyetur subjektin mbi kursimet *cash* ndër vite, dhe subjekti në përgjigje të *email*-it të Komisionit, të datës **\*\*\*.11.2018**, ka deklaruar se ka disponuar kursime *cash* në gjithë periudhën 2003-2016 (duke deklaruar dhe vlerat përkatëse). Komisioni i ka konsideruar këto kursime të deklaruara nga subjekti në vitin 2019, si kursime të viteve 2003-2016.

---

<sup>10</sup> Shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, të datës **\*\*\* .2.2019**, që konfirmon se biznesi i bashkëshortes së subjektit, “**\*\*\***” sh.p.k., ka detyrime të papaguara “tatim fitimi i thjeshtuar”, në shumën 110.000 lekë.

- Kursimet në llogaritë bankare janë bazuar në vërtetimet e bankave të nivelit të dytë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

## **II.A.2**

22. Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, në referencë të nevojës së kryerjes së një hetimi të plotë dhe verifikimit të ekzistencës eventuale të të gjitha kushteve të parashikuara nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, mangësitë në hetimin e Komisionit edhe në drejtim të administrimit të plotë të informacioneve nga të gjitha organet ndihmëse për kriterin e figurës, do të duhet të riparohen gjatë gjykimit të këtij ankimi në Kolegj.

## **III. Kërkimi i ankimit**

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmartja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

25. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr.183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**